

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit J.B. , nga fshati , Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1086/2015 të datës 28.05.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Mehreme Hoxha, të akuzuarit, mbrojtësit të akuzuarit, avokat N.Q. , të dëmtuarve D.M. , përfaqësuesit të tij avokaat N.Sh. dhe të dëmtuarit A.F. , me date 22.07.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J.B., nga i ati M. dhe nëna Gj. e lindur Gj. , i lindur me datë “data e lindjes..” në Prizren, tani jeton në fshatin , Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollë fillore, punëtor, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetar i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 03.04.2015, rreth orës 08,19 minuta, në fshatin , Komuna e Prizrenit, i kanoset seriozisht tani të dëmtuarit D.M. , me anë të telefonit duke i thënë “D.M. ruaju se prej sot kam me të vra”, si dhe të njëjtit dhe të dëmtuarve A.F. dhe E.M. , ju dërgon mesazhe me anë të telefonit duke i kërcënuar “me jetë”, në atë mënyrë që për shkak se të pandehurit dhe tërë fshatit po ju pengonte kinse një lidhje e fshehtë që e kishin krijuar A.F. dhe E.M. , ditën kritike i pandehuri fillimisht e thërret në telefon të dëmtuarin D.M. dhe e kërcënon me fjalët “D.M. ruaju se prej sot kam me të vra”, gjersa pas pak i dërgon sms, të cilin e kërcënon “me jetë” bashkë me kumatën e tij – të dëmtuarën E.M. dhe fqiun e tij – të dëmtuarin A.F. , gjithashtu në të njëjtën ditë, rreth orës 09,46 minuta, i pandehuri i dërgon sms të dëmtuarit A.F. , me përmbajtje të njëjta kërcënuese, me ç’ rast tek të dëmtuarit shkakton frikë dhe ankth,

Këso dore ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 42, 43 par.1 pika 1.2, 45, 73, 74, 75, 76 dhe 185 par.2 të KP-ës, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIM ME BURG

Në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji

Të dëmtuarit E.M. dhe D.M. , të dy nga fshati , për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjyakte i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1086/2015 të datës 28.05.2015, në lenden penale kundër të akzuarit J.B. , nga fshati , Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KP-ës.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.04.2016, Prokurori i shtetit ka bërë ri cilësimin juridik e veprës penale nga vepra penale kanosje nga neni 185 par 1 të KP-së, në veprën penale kanosje nga neni 185 par. 2 të KP-së, ndërsa në pjesën tjetër aktakuza mbetet e pandryshuar.

Prokurori i shtetit Mehreme Hoxha deklaron që fjalën përfundimtare e ka parashtruar me shkrim, dhe e njëjta sot i parashtron fjalën përfundimtare në kopje të mjaftueshme për të gjitha palët në procedurë si dhe për gjykatën. Në vazhdim thekson që duke pasur parasysh fjalën përfundimtare me shkrim të njëjtën e elaboron në pikat të shkurtra dhe atë në drejtim të asaj që nga të cekurat mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.1086/2015 të datës 28.05.2015,

Nga fjala përfundimtare e prokurorisë të shtetit të parashtruar me shkrim theksohet se nga administrimi i provave në seancat gjyqësore të zhvilluara me datë 04.04.2016, 11.05.2016, 20.06.2016 dhe 13.07.2016, është vërtetuar në tërësi gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Nga deklarata e të dëmtuarit D.M. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 11.05.2016, arrihet të kuptohet se i njëjti pas një periode kohore e ka kuptuar se mesazhin me përmbajtje kërcënuese ka qenë i dërguar nga ana e të pandehurit dhe pasi që ka shkuar bashkë me vëllezërit e tij dhe të dëmtuarin A.F. , tek i pandehuri J.B. , i njëjti ka pranuar se mesazhi është dërguar nga telefoni i tij, por nga kush është dërguar nuk e din.

Po ashtu i dëmtuari D.M., thekson se ka tentuar disa herë të thrras dhe i ka dërguar mesazhe numrit nga i cili kishin ardhur mesazhe kërcënuese, por nuk i është përgjegjur i pandehuri.

Në deklaratën e të dëmtuarit A.F., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.05.2016, thekson se numri i telefonit nga i cili ka pranuar mesazhin me përmbajtje kërcënuese ka qenë identik me numrin e telefonit i cili poashtu kishte dërguar mesazh tek i dëmtuari D.M. dhe se gjithashtu përmbajtja ka qenë përafërsisht e njëjtë dhe pos tjerash në mesazh ka qenë fjala “kemi me të vra”.

Edhe nga deklarata e të dëmtuarit A.F., vërtetohet se kanë shkuar bashk me të dëmtuarin D.M., bashkë me vëllezërit e tij tek i pandehuri J.B. dhe se përgjegja e tij ka qenë se dikush kinse ja ka keqpërdorur telefonin, duke mos theksuar se kush ka mundur të ja keqpërdor telefonin.

Nga dëshmia e dëshmitarit – zyrtarit policor H.B. , të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.06.2016, vërtetohet se numri i telefonit nga i cili janë dërguar mesazhet është i një personi nga Ferizaj, por numri i IMEI i telefonit ka qenë i të pandehurit J.B. dhe as dërgimit të mesazhit me përmbajtje kërcënuese përsëri është vendosur SIM kartela me numrin e të pandehurit J.B. , në po atë telefon dhe se lokacioni nga i cili janë dërguar mesazhet ka qenë nga fshati , komuna e Prizrenit, fjala është për SIM kartelat e telefonit. E gjithë kjo sipas dëshmitarit kuptohet se ka rezultuar nga përgjigja e Operatorit Vala, ku si provë sipas dëshmitarit është bashkangjitur edhe CD-ja, ku tregon për numrat e IMEI, numrat kontaktues si dhe lokacioni prej nga është përdorur telefoni respektivisht nga vendi ku janë dërguar mesazhe.

Edhe nga mbrojtja e të pandehurit J.B. , të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 13.07.2016, vërtetohet se është kontraktitor në deklaratimet e tij, për ditën kritike, sipas tij atë ditë nuk ka punuar për shkak të kushteve klimatike, kurse në deklaratën e tij të dhënë në stacionin policor deklaroi se atë ditë ka qenë në Mamushë duke punuar. Gjithashtu pas tjerash pasi i rikujtohet deklarata e dhënë në polici, i njëjti thekson se “është bërë ndonjë gabim”, fjala është rreth përdorimit të telefonit të tij, këtë e arsyeton se në deklaratën e tij të dhënë në stacionin policor ka qenë me emocione.

Deklarimet e të pandehurit janë në drejtim të shmangies të përgjegjësisë penale nga ana e tij dhe në kundërshtim me faktet dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj proozoj që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit D.M., avokat N.Sh., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: në tërësi e përkrahi dhe e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit të dorëzuar sot në gjykatë në formë të shkruar, duke shtuar që si përfaqësues i palës së dëmtuar D.M. , shprehi keq ardhje në një drejtim dhe ate që i dëmtuari dhe këtu i akuzuari janë të njëjtit fshati, kanë pasur raporte të shëndosha, por pas këtij rasti raportet e tyre kanë ndryshuar në kontest asaj që nuk janë më ashtu si kanë qenë, po ashtu që nga dita e pranimit të kësaj SMS-si me përmbajtje të kanosjes, familja e të dëmtuarit, duke përfshirë edhe dëshmitarin B.M. , janë ankth, ngase e dëmtuara E.M. ka qenë bashkëshorte e këtu dëshmitarit, dhe nga ky SMS e njëjta edhe e ka braktisur, dhe tani janë të ndarë gjegjësisht bashkësia e tyre familjare – martesore ka përfunduar si shkak të këtij SMS-i. Këtë e them nga fakti që duke pasur parasysh edhe tradita tona, andaj edhe nga fakti që këtu i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pranuar që SMS janë dërguar nga telefoni i tij privat mobil, që të cilin fakt e vërteton edhe dëshmitari prezent zyrtari policor H.B. i

cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar që sa i përket edhe telefonit gjegjësisht IMEI të telefonit është këtu të akuzuarit, ndërsa sa i përket dërgimit të SMS-it që është objekt i kësaj çështje penale, i njëjti është dërguar nga zona e cila i përket fshatit , nga ku janë edhe i akuzuari edhe i dëmtuari, e këto të dhëna dhe prova dëshmitari i cekur i ka vërtetuar në bazë të raporteve nga ana e PTK-ës – Vala 900, si dhe e njëjta vërtetohet edhe në bazë të CD-ës e cila CD është administruar si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa i akuzuari nuk e ka pranuar që ai ka qenë autori i atij shkrimit – tekstit, e sipas mendimit të mbrojtjes të dëmtuarit qëllimi i një deklaratë të tillë ka për qëllim vetëm shmangien nga përgjegjësia penale, dhe vënien në lajthim të gjykatës me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit. Nga të gjitha këto, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, pasojën e cekur të shkaktuar, konform dispozitës së nenit 45 të KP-ës, propozoj gjykatës shqiptimin e dënimit me burg, e cila do të ndikoj në të ardhmen që i njëjti mos të përsëritë veprat të tilla apo të ngjashme.

I dëmtuari D.M. në fjalën e tij përfundimtare deklaron, e përkrahi dhe e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, dhe përfaqësuesit tim, duke shtuar që parashtroj kërkesë pronësoro juridike, për lartësinë e të cilës shumë do të deklarohej në kontestin të rregullt civil.

I dëmtuari A.F. në fjalën e tij përfundimtare deklaron, në tërësi e përkrahi dhe e mbështes fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit , ndërsa si palë e dëmtuar nuk parashtroj kërkesë pronësoro juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.B., avokat N.Q. , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: që në fillim të fjalës time përfundimtare shprehi keq ardhje për këtë çështje penale sa i përket të mbrojturit tim, në raport me këtu të dëmtuarin dhe familjen e tij. Këtë e them nga fakti që edhe nga deklaratat e të mbrojturit tim gjatë shqyrtimit gjyqësor, por edhe nga deklaratat e të dëmtuarve dhe dëshmitarit vijmë në përfundim që raportet në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarve kanë qenë raporte shumë miqësore, ku me një rast i mbrojturi im gjatë mbrojtës të tij deklaron që vëllaun e dytë të dëmtuarit D.M. , F.M. e ka pas si vëlla, së bashku familjarisht kanë festuar të gjitha rastet e gëzimit, e po ashtu së bashku kanë qenë familjarisht edhe në mbledhi të ndryshme, nga kjo shtrihet edhe pyetja çka e ka shtyer të akuzuarin J.B. të dërgoj këtë SMS, ku ka qenë qëllimi i tij, ngase i akuzuari J.B. njihet si person i urtë, i qetë dhe se e mban familjen me punë në ndërtimtarë. Po ashtu gjatë deklaratës së saj e dëmtuara E.M. , deklaron në pyetje të parashtruar pikërisht nga unë se a e dinë vetën të kërcënuar me këtë SMS e njëjta ka deklaruar që nuk ka ndier vetën të kërcënuar e as të kanosur. Në vazhdim theksoj që numri i telefonit nga i cili është dërguar SMS-i nuk ka qenë numri i të mbrojturit tim. Numri nga i cili është dërguar SMS-i i ka takuar një personit tjetër, e lidhur me këtë numër tjetër nuk është bërë asnjë hetim as nga zyrtarët policor e as nga prokuroria. I vetmi burim nga i cili rrjedh që në veprimet e të mbrojturit tim ka elemente të kësaj veprë, qëndron në atë që telefoni ka qenë i tij, në bazë të IMEI. A mund të shpallet dikush fajtor për një mos veprim të tillë, ngase i mbrojturi im që nga fillimi në mënyrë

kategorike e ka mohuar kryerjen e kësaj veprë, i njëjti por edhe për kundër udhëzimeve të gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i ofron pranimi i fajësisë konform dispozitave ligjore, duke pasur parasysh raportet e shëndosha familjare që kanë qenë në mesë të këtyre dy familjeve me siguri që në fillim do ta kishte pranuar fajësinë. Andaj, duke pasur parasysh që i njëjti nuk e ndien veten fajtor, nuk ka mundur as ta pranojë fajësinë. Po ashtu në veprat penale të kësaj natyre, kërkohet edhe dashja si element i kryerjes së veprës penale, e dashja më së paku ka ekzistuar te këtu i akuzuari. Andaj edhe konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha këto rrethana janë rrethana të cilat na dërgojnë në përfundim që asnjë nga elementet qenësore të veprës penale të kanosjes në veprimet e të mbrojturit tim nuk kanë ekzistuar. Në fund i propozoj gjykatës që në mungesë të provave dhe në mungesë të veprimit të drejt për drejt të mbrojturit tim që i njëjti të lirohet nga akuza.

I akuzuari J.B. , në fjalën e tij përfundimtare deklaron: në tërësi e përkrahi dhe e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, më vije keq për tërë që ka ndodhur, edhe gjatë fjalës time në mbrojtjen time, kam shprehur keq ardhje për shkak raporteve që i kemi pasur me të dëmtuarin dhe familjen e tij. Theksoj që unë F. vëllaun e të dëmtuarit D. e kam pasë si vëlla, familjarët e të njëjtit i kam respektuar dhe çmuar, por tërë këto raporte kanë ndryshuar nëp kontest negativ pas kësaj ngjarje. Unë edhe në fjalën e mbrojtjes sime, kam përshkruar raportet e mia me familjen M. , dhe e di që kjo afërsi familjare më nuk është si ka qenë përpara, e kjo nga pala e dëmtuar. Kjo ftohje e raporteve, për mua paraqet një dhimbje, ngase e tëra kjo është paraqitur pa fajin tim, pa veprimet e mia, edhe unë kam dëshirë të dijë kush e bëri këtë veprim, kush qe shkaktar tërë kësaj të ngjallë, e kjo të ndodh e unë të pësoj, kjo më mbren më së shumti. Unë e di që unë nuk e kam bërë këtë veprim, andaj edhe i propozoj gjykatës që ndaj meje të marr një aktgjykim lirues, duke pasur parasysh të gjitha të cekurat më lart, gjendjen time familjare, që jam baba i katër fëmijëve, dhe me punën time si punëtor ndërtimtarie kujdesem dhe jam i vetmi që e siguroj ekzistencën e familjes sime. Të gjitha këto rrethana i propozoj gjykatës që ti ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit në këtë çështje penale.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 03.04.2015, rreth orës 08,19 minuta, i akuzuari, në fshatin , Komuna e Prizrenit, i kanoset seriozisht tani të dëmtuarit D.M. , me anë të telefonit duke i thënë “D. ruaju se prej sot kam me të vra”, si dhe të njëjtit dhe të dëmtuarve A.F. dhe E.M., ju dërgon mesazhe me anë të telefonit duke i kërcënuar “me jetë”, në atë mënyrë që për shkak se të pandehurit dhe tërë fshatit po ju pengonte kinse një lidhje e fshehtë që e kishin krijuar A.F. dhe E.M. , ditën kritike i pandehuri fillimisht e thërret në telefon të dëmtuarin D.M. dhe e kërcënon me fjalët “D.M. ruaju se prej sot kam me të vra”, gjersa pas pak i dërgon sms, të cilin e kërcënon “me jetë” bashkë me kunatën e tij – të dëmtuarën E.M. dhe fqinun e tij – të dëmtuarin A.F. , gjithashtu në të njëjtën ditë, rreth orës 09,46 minuta, i pandehuri i dërgon sms të dëmtuarit A.F. , me përmbajtje të njëjta kërcënuese, me ç’ rast tek të dëmtuarit shkakton frikë dhe ankth,

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe ate deklaratës të akuzuarit, deklaratës të dëmtuarve E.M. , D.M. dhe A.F. , dëshmitarve B.M. dhe H.B. , dhe provave materiale kallëzimit penal nr.-GA-.... të datës 27.04.2015, raportit fillestar të incidentit, raporti i oficerit të datës 03.04.2015, procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarës E.M. , në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit D.M. , në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit A.F. , në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B.M. , në procedurën parapenale, CD, pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësin penal juridike të akuzuarit, nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-së, duke vërtetuar paraprakisht përgjegjësinë penal juridike të akuzuarit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëmtuarës E.M. , e cila në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.04.2016, deklaroi: Unë jam martuar në fshatin me B.M. , dhe para 12 viteve jam njohur si bashkëfshatar të bashkëshortit tim me këtu të akuzuarin. Kunatit tim këtu të dëmtuarit D.M. , i ka dërguar një SMS J.B. , i cili më ka dhënë për ta lexuar edhe unë të njëjtin, unë e kam lexuar nga telefoni i kunatit tim D.M. , meqenëse ka kaluar një kohë e gjatë, mund të më kujtohet përafërsisht teksti si në vijime “D.M. , A.F., fjala është për të dëmtuarin A.F. , është duke ju bërë horë juve dhe familjen tuaj, ti e dinë që A.F. është duke shkuar me atë kudër”, fjala kudër ka qenë sinonim për mua, në vazhdim më kujtohet edhe fjalët “jam duke ju ruajt, du me ju vra”, sa më kujtohet për afërsisht, pasi që ka kaluar një kohë e gjatë. Emrin tim konkretisht nuk e kam lexuar, por fjala gruaja e B.M. dhe kudër ka qëndruar, e ato fjalë kanë qenë në bazë të kuptimit të drejtuar për mua si person. Fjalë kërcënuese kanë qenë sipas mendimit tim në SMS-ën e dërguar nga i akuzuari, kam me ju vra ty, fjala është për D.M. , A.F. dhe atë kudër, fjala është për mua, jam duke ju ruajt se kam me ju vra kështu ka qenë fjala sa më kujtohet për momentin.

J.B. , ka ardhur shpesh tek vëllezërit e B.M. , bashkëshortit tim, kanë ndejtur dhe biseduar, mua personalisht bisedat e tyre nuk më kanë interesuar. Po e njoh, të dëmtuarin A.F. , që një kohë prej 12 viteve. Nuk më kujtohet numri i telefonit ... - ... - ... se i kujt është ky numër. Nuk e di që kanë pasur ndonjë problem në mes të familjes sime dhe të dëmtuarit A.F. , raportet kanë qenë të shëndosha sa kam pa unë. Në momentin kur e kam lexuar mesazhin kam qenë në shtëpinë time, Jo nuk më ka treguar D.M. që paraprakisht ka biseduar me të njëjtin numër me telefon nga e cili erdhi mesazhi. Po kanë qenë edhe anëtarët të tjerë të familjes atë ditë në shtëpi, bashkëshorti dhe fëmijët. Kur kam lexuar mesazhet e kam ndier vetën pak të shqetësuar, përmbajtja e tekstit ka qenë për shqetësim, edhe pse unë e di që askujt asgjë të keqe nuk i kam bërë. Nuk e di. a provoj dikush nga familja që ta thërrasë atë numër. Nuk e kemi ditur, as unë personalisht apo ndonjë anëtar i familjes se numri i kujt është ai numër. Nuk mund të deklaroj konkretisht, por 20-25 minuta në këmbë, është larg shtëpia ime ku kam banuar te bashkëshorti nga shtëpia e këtu të akuzuarit J.B. . Kam dëgjuar shpesh që kanë biseduar bashkëshorti im apo kunati im me të akuzuarin J.B., andaj ndoshta edhe e kanë ditur numrin e J.B. .

Unë kam qenë në Shqipëri, e vendosur tek familja ime, për shkak të shkëputjes momentale të bashkësisë familjare, dhe më është lajmëruar me telefon bashkëshorti im B.M. , dhe më ka njoftuar që mesazhi i dërguar në telefonin e D.M. ka qenë nga J.B. . Mund të them lirisht që kjo ka ndodhur diku rreth 5-6 javë mbase dërgimit të mesazhit, unë kam shkuar në Shqipëri, ndërsa B.M. më është lajmëruar në telefon diku në fund të vitit 2015. Askush nga anëtarët e familjes time nuk ka kërkuar të bisedoj me J.B. lidhur me këtë kanosje, fjala është për familjarët e ngushtë të familjes sate. Jo nuk e di aq që sa kam njohuri lidhur me te që këtu i pandehuri J.B. të ketë dërguar SMS-a kërcënuese dhe përmbajtje kërcënuese mua personalisht apo bashkëshortit tim. Mua personalisht këtu i pandehuri J.B. , nuk më ka ftuar. Unë personalisht kam lexuar vetëm një mesazh, përmbajtjen e të cilës e theksova më lart, aq sa më kujtohet

Unë të akuzuarin J.B. e kam njohur vetëm si bashkë fshatar, nuk kam dëgjuar e as që më ka ra në vesh ndonjë karakteristik e posaçme lidhur me personalitetin e tij.

Në fund deklaroj që familjarët e bashkëshortit tim, pra fjala është për familjen M. nga fshati kanë dërguar njerëz të familjes tek familja e J.B. , lidhur me sqarimin e kësaj çështje, sa i përket rezultateve dhe përfundimeve të këtyre bisedave unë nuk jam në dijeni, ngase si ceka më lart për shkak të problemeve familjare, përkohësisht kam shkëputur bashkësinë familjare – martesore, dhe që nga dhjetori i vitit 2015 unë jetoj tek familjarët te mi në Fushë Arës, Republika e Shqipërisë, theksoj në vazhdim që kjo nuk është shkëputja e parë e përkohshme e bashkësisë familjare.

I dëmtuari D.M. , në shqyrtimin gjyqësor me datën 11.05.2016 deklaroi: Po më kujtohet me datë 03.04.2015, kam qenë në shtëpi. Ditën kritike më ka shkruar një SMS, i cili ka arritur në numrin tim të telefonit ... / ... - ... , nëpërmjet telefonit me numër ... / ... - ... , dhe atë me përmbajtje siç është në aktakuzë. Dua të theksoj që në ditën e cekur i kam pranuar dy SMS dhe ate në orët e cekura si në aktakuzë. Jo nuk ka qenë me numër të mshefur, por ka qenë me numër që ceka më lartë. E morra SMS dhe fillova ta lexoj dhe shkova te vëllau im B.M. , këtu i propozuar si dëshmitar, e njoftova familjen e vëllaut me të cilin jemi ndarë nga bashkësia familjare dhe secili e ka amëvisrinë e vet, por shtëpin e kam afër tij në ecje normale 3 deri 5 minuta, por në moment i njëjti ishte duke fjetur dhe lidhur me këtë e njoftova bashkëshorten e tij këtu të dëmtuarën E.M. , atëherë e kam thirr vëllaun tjetër L.M. , që është më i vjetri nga të gjithë ne, i tregova atij nëpërmjet telefonit dhe e ftova që të vijë të më marrë në shtëpi të më dërgoj në stacionin policor për të treguar rastin. Jo nuk kam komunikuar me këtë numër që e theksova ara datës kritike. Para ditës kritike raportet – sjelljet mes meje dhe të akuzuarit kanë qenë shumë të mira, kemi qenë bashkëfshatar dhe i kemi ndihmuar njëri tjetrit, këtu i akuzauri ka ardhur në shtëpinë tonë, i njëjti e ka ndërtuar shtëpinë tonë, pasi që punon si murator, shkurt kemi pasur raporte të shëndosha. Gjatë këtyre raporteve të shëndosha kam komunikuar me telefon me të akuzuarin, por nuk ka qenë numri nga i cili më është dërguar SMS. Numri i telefonit me të cilin kam komunikuar me këtu të akuzuarin ka qenë ... / ... - Numri i telefonit nga i cili më janë

dërguar SMS, kam kuptuar që është i këtu të akuzuarit J.B. , pas një kohe relativisht të gjatë, nuk më kujtohet saktë, por e di që kam kuptuar për J.B. , kur kam shkuar në prokurori dhe atë pas dy tri herave. SMS nga J.B. , më ka ardhur në telefonin që e kam pasur në atë kohë dhe atë në muajin prill të vitit 2015, pas arritjes të këtij SMS më telefonin nuk e përdori dhe të njëjtin e ruaj si provë për SMS e pranuar. Tani e kam në përdorim një telefon tjetër, por numri është i njëjtë. Në atë moment në telefonin që e kam pas në përdorim ka pas të regjistruar numra dhe SMS, numri konkret i të cilëve nuk më kujtohet, e sa i përket ndonjë SIM kartelet tjetër të vendosur në këtë telefon, dua të theksoj që këtë telefon e kam marr me ndërrim me vëllaun e shoqes të vëllaut tim në Shqipëri, i cili ka ardhur për vizitë te familja jonë.

Pas njoftimit dhe kuptimit që J.B. më ka dërguar SMS, kam tentuar të komunikaohj dhe të kërkoj sqarime nga i njëjti për shkakun, arsyet e këtu SMS, dhe kam shkuar së bashku me vëllezërit e mi L.M. dhe B.M., si dhe me A.F. , i cili edhe e ka njoftuar J.B. , për arsyet e vizitës tonë tek ai. J.B. me të kuptuar këtë është përgjigjur që po SMS është dërguar nga telefoni im, por kush e ka dërguar i njëjti është përgjigjur që nuk e din, ngase dikush e ka përdorur telefonin e tij për dërgimin e SMS, por kush këtë i njëjti nuk e ka ditur. Gjatë bisedës që kemi zhvilluar me J.B. , kam vërejtur ndryshim në pikëpamje vizuale të jashtme, që i ka ndërruar pak fytyra, pra duke pasur parasysh fytyrën e tij kam vërejtur disa ndryshime në figurën e tij, të manifestuara në mënyrë të skuqjes së fytyrës. I akuzuari J.B. nuk ka përmendur raste të mëparshme që dikush të ja ketë përdorur telefonin. Pasi që kam pranuar SMS e kam ndier veten të kërcënuar.

E kam takuar J.B. edhe në periudhën kur e kam pranuar SMS deri në ditën kur sipas meje kam kuptuar që i njëjti më ka dërguar SMS, pasi që i njëjti ka punuar te xhaxhai im, i njëjti më ka shoqëruar me automjetin e tij sa herë më ka takuar në rrugë dhe më ka shoqëruar në destinacionin tim. Të gjithë e kanë kuptuar për SMS e dërguar, fshati, rrethi, shoqëria ku jetoj dhe veproj.

Nga dita kur e kam pranuar SMS, e deri në ditën sipas meje kam kuptuar që J.B. më ka dërguar SMS, kam provuar shumë herë të thërras numrin nga i cili më është dërguar SMS, por asnjëherë nuk më është përgjigjur, i kam dërguar edhe SMS, por të gjitha pa sukses, por edhe pasi kam kuptuar që J.B. më ka dërguar SMS, kam tentuar ta thërras numrin e njëjtë por prap pa sukses. Është e vërtet që ne kemi pasur raporte të shëndosha, sa i përket arsyes, motivit apo shkakut, me të vërtet nuk e di.

Kur kemi shkuar te J.B. , pritja e tij ka qenë normale, na ka shërbyer me pije në mënyrë të traditës. Nuk kemi kërkuar nga J.B. që të betohet sipas traditës, por vëllau i J.B. , Gj.B. , ka thënë nëse vertetohet që vëllau im J.B. e ka dërguar këtë SMS, i njëjti le të mbaj me shënet, në drejtim të asaj që i njëjti duhet të bartë edhe përgjegjësin. Unë nuk kam dërguar njerëz në formë të këshillave të pajtimit për të kërkuar sqarim nga veprimi i J.B. , ngase kam pritur që Jozefi të më dërgoj mua burra në formë të ndërmjetësimit. Po am frikësuar dhe e kam ndier veten të frikësuar

nga personi dërgues i SMS. Edhe pas kuptimit që J.B. më ka dërguar SMS jam frikësuar, edhe sot e ndiej veten të frikësuar nga përmbajtja e këtij SMS. J.B. , nuk më është kërcnuar nga takimi me te, por i njëjti edhe ka shprehur keqëarrdhje për atë që ka ndodhur pa marr parasysht se kush e ka dërguar SMS. Unë tërë këtë veprim i kam lënë që të kërkohet fajtori nëpërmjet organeve gjyqësore.

Nga momenti kur e kam kuptuar që J.B. më ka dërguar SMS, më nuk kam pasur kontakte me të njëjtin, ngase paraprakisht deri sa e kam marr vesh kam qenë në raporte të mira, por pas kuptimit se ai më ka dërguar SMS, më me të njëjtin i kam shkëputur raportet. Por si theksova edhe më heret, unë e ndiej veten të kërcënuar, të frikësuar deri në momentin e zgjedhjes të kësaj çështje penale. Deri në momentin kur e kam kuptuar që J.B. më ka dërguar SMS përmes telefonit të tij raportet i kemi pasur normale, por që nga momenti që kam kuptuar, me të njëjtin i kemi shkëputur në përgjithësi raportet si theksova më lartë, nuk kemi më as hyrje e as dalje, nuk kemi më as përshëndetje, e as shoqërim me automjet si ka qenë përpara, e po ashtu i njëjti nuk ka ardhur në punët e muratorisë në shtëpinë tonë.

Po më ka ardhur edhe një kërcënim tjetër pas kërcënimit të J.B. , me përmbajtje “ O D.M. qeni ku je, o qen ske me pështu lehtë, shpirtin kena me ta marrë”, SMS i dërguar nga numri i telefonit ... / ... - ... me datë 26.04.2015, në ora 14:15 minuta. Poashtu kam shkuar ta lajmëroj edhe këtë SMS në polici, por zyrtarët policor më kanë thënë se është personi i njëjtë që më ka dërguar SMS që është objekt i kësaj çështje penale. Të nesërmen me datë 27.04.2015, në ora 09:04 minuta, më ka ardhur edhe një SMS me përmbajtje identike të cekur më lartë, me shtojcën “xhenaze ko me të bo”, me numër të njëjtë si një ditë paraprake, nga ky numër sa kam dijeni unë. SMS i janë dërguar edhe të dëmtuarit A.F. , nuk e di numri i kujt është ky, po ashtu kam tentuar që të e thërras, por pa sukses.

Jo nuk e di kush janë pronarët e këtyre dy numrave. Nuk kam pasur ndonjë SMS tjetër nga këta numra, e as telefonata nga këta dy numra, kam tentuar që ti thërras këta numra, por pa sukses.

I dëmtuari A.F. , në shqyrtimin gjyqësor me datën 11.05.2016 deklaroi: Kam pranuar një SMS kërcënues dhe në SMS të cekur ka qenë i përmendur edhe emri i D.M. , këtu po ashtu i dëmtuar. E kam ftuar D.M. me telefon dhe i njëjti më ka shpjeguar që po edhe ai e ka pranuar një SMS të tillë dhe se rastin e ka paraqitur në polici dhe se organet e ndjekjes janë duke e hetuar këtë rast. Numri i saktë nga i cili kam marrë SMS nuk më kujtohet, por pas takimit me D.M., kemi gjetur se numri i telefonit nga i cili është dërguar SMS është identik me numrin nga i cili edhe D.M. i është dërguar SMS, sa i përket përmbajtjes thuaja që edhe ajo përafërsisht ka qenë e njëjtë. Përmbajtja konkrete nuk më kujtohet, por e di që ka qëndruar fjala “kemi me të vra”. Para ditës kritike nuk kam qenë ndonjëherë i kërcënuar nga ana e J.B. . Jo nuk e kam ndier veten të kanosur apo të frikësuar pas ditës kritike kur kam kuptuar se mund të jetë dërgues eventual i

SMS këtu i pandehuri. Unë nuk besoj dhe as nuk dëshiroj të besoj që këtu i akuzuari J.B. të ketë dërguar këtë SMS, ngase me të njëjtin kemi qenë në raporte të shëndosha si bashkëfshatar, e kemi respektuar njëri tjetrin, kur ka pas nevojë të njëjtin e kam ndihmuar me mjete materiale dhe me sende të nevojshme, i njëjti ka punuar tek unë në firmën time, andaj nuk e di arsyen, shkakun dhe motivin që do të shtyente që i njëjti të dërgoj SMS me përmbajtje të tillë. Kam tentuar të thërras numrin me të cilin më është dërguar SMS, në fillim cingëronte zilja dhe nuk e hapte askush e më vonë i tërë numri nuk kishte qasje në rrjet, ishte i mbyllur. Derisa kam kuptuar që i njëjti është dërgues eventual, raportet kanë qenë të shëndosha, por pas kësaj kur kam kuptuar na kan mbetur vetëm një përshëndetje formale ku takohemi dhe shihemi.

Për herë të parë kam kuptuar që dërguesi eventual i SMS kërcënues është këtu i akuzuari J.B. dhe këtë e kam kuptuar nga këtu i dëmtuari D.M. , i cili më ka ftuar në telefon dhe më ka njoftuar që dërguesi i SMS është J.B. . Pasi që u njoftoi D.M. që dërguesi eventual është J.B. , kemi shkuar në shtëpin e tij unë, D.M. dhe dy vëllezërit e D.M. , B.M. , këtu dëshmitar dhe L.M. . Kur kemi arritur në shtëpin e J.B., unë kam kërkuar nga i njëjti sqarim lidhur me SMS, por i njëjti më është përgjegjur se dikush ma ka keqpërdorur telefonin, duke mos theksuar konkretisht askend. Në vazhdim i njëjti më ka njoftuar që keqërdorimi i telefonit të tij është bërë në atë mënyrë që dikush e ka ndërruar SIM kartelën në aparatin e tij telefonik dhe të njëjtin e ka përdorur për dërgimin e SMS, numri nga i cili është dërguar SMS, J.B. ka thënë se nuk e din se i kujt është. Nuk ka përmendur ndonjë emër, mbiemër apo person konkret për të cilin J.B. dyshon. Po ashtu nuk ka përmendur vendin ku ka mundur të keqpërdoret telefoni. Nuk ka përmendur ndonjë rast tjetër të keqpërdorimit të telefonit të tij nga kush do qoftë. E kemi pyetur J.B. , se ku ka qenë në kohën kur janë lëshuar SMS dhe i njëjti na është përgjegjur se ka qenë në punë dhe pasi që ka rënë shi, i njëjti është kthyer në shtëpi, pasi që i njëjti ka punuar si murator në ndërtimtari. Nuk e di ku ka punuar J.B. në atë kohë. Nuk na ka treguar dhe nuk më kujtohet që J.B. të na ketë treguar kohën kur është nisur në punë dhe kur është kthyer nga puna. Atë ditë kur kemi shkuar për të kërkuar sqarim të J.B. , ka qenë kërkesë e neve treve si dhe e L.M. . J.B. , atë ditë kur kemi qenë në shtëpinë e tij ka qenë pak i shqetësuar sa kam mundur të vërej, pak i skuqur, e cila ka qenë arsyeja nuk mund të di. Në momentin e pranimit të SMS e kam ndier veten të shqetësuar, por i kërcnuar jo, as i frikësuar, ngase ta kisha ndier veten të frikësuar apo të kërcnuar nuk kisha dal në punë, e unë kam dal në punë normalisht.

Me të akuzuarin theksova se i kemi raportet e ftofta, kjo nënkupton që ne në mes veti përsëri kemi raporte të them vetëm formale të përshëndetjes kur hasemi në mes vete. Por nuk janë ato raporte që kanë qenë më përpara që kur takoheshim përqafoheshim në mënyrë më të afërt, ndonjëherë edhe talleshim në mes veti për disponim, e ftonim njëri tjetrin për kafe në lokal, por nuk është e thënë që tani e tutje nuk do të pijë kafe me të njëjtin nëse më jepet mundësia.

Raportet me familjen M. kanë qenë shumë të mira dhe vazhdojnë të jenë të tilla edhe pas datës 03.04.2015, por pak janë lëkundur prej rastit të fundit.

I dëmtuari A.F. , në vazhdim të deklaratës së tij në shqyrtimin gjyqësor me datën 20.06.2016, deklaron: I akuzuari J.B. në ditën kur kemi qenë në shtëpinë e tij ka shprehur gatishmëri për të gjitha, dhe është betuar që do të qëndroj në fjalë dhe mund të betohej që do ti plotësoj të gjitha kushtet që do ti ofronim, si për vete ashtu edhe për mua. Raportet me të akuzuarin J.B. para rastit të ndodhur kanë qenë të shëndosha. Në momentin e shkaktimit të veprës nga ana e të akuzuarit, kanë ndikuar raportet në mes nesh. Sot me të akuzuarin i kemi raportet jo siç i kemi pasur para rastit të ndodhur, ka ndikuar vepra nga ana e të akuzuarit, por për herë them që nuk kanë janë siç kanë qenë, e tëra që na ka mbetur nga raportet e mëparshme, është vetëm një përshëndetje. SMS i dërguar nga i akuzuari, frikë nuk më ka shkaktuar, por kam një lloje shqetësimi nga përmbajtja e SMS-it.

Dëshmitari B.M. , në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.06.2016, deklaron: po më kujtohet deklarata e dhënë lidhur me rastin që e kam dhënë në Stacionin policor.Përmbajtjen e kam kuptuar për dërgimin e SMS-it të J.B. nga vëllau im D.M. . Përmbajtja për momentin nuk më kujtohet, ngase vetëm e kam pa në mënyrë sipërfaqësore, ma ka lexuar vëllau, e unë nga shqetësimi momental nuk jam lëshuar në përmbajtjen e të njëjtit. Për personat që janë përmendur në përmbajtjen e SMS e di që është përmendur A.F. .Nuk e di për përmendjen e ndonjë personit tjetër, kam qenë tepër i shqetësuar në momentin e kuptimit të SMS nga vëllau, pasi që ky SMS ka pasur për pasojë kërcënimin dhe kanosjen. Po konsideroj që përmbajtja siç ma ka komunikuar vëllau im ka shkaktim të frikës dhe ankthit. SMS ka ardhur nga J.B. . E kam kuptuar nga ana e Prokurorisë, e cila më ka njoftuar që dërguesi i SMS është këtu i akuzuari J.B. . Raportet i kemi pasur shumë të mira me të akuzuarin J.B. para datës 03.04.2015. Pas rastit të ndodhur kemi kërkuar sqarim nga J.B. dhe për arsyen që ka shkaktuar një veprim të tillë, kemi shkuar te i njëjti unë, dy vëllezërit e mi D.M. dhe L.M. , si dhe A.F. . Kur kemi shkuar, A.F. i është drejtuar J.B. o burë, nëse është e vërtet atë që ke shkruar, dhe nëse din diçka në lidhje me mua, urdhëro vëmë në barë tërë këtë, në atë moment kam vërejtur që J.B. është shqetësuar në kuptim të ngjyrës dhe tenit të fytyrës dhe ka filluar të dridhej, vetëm na është drejtuar me fjalët ma kanë përdorur telefonin. I akuzuari J.B. edhe për kundër insistimit tonë, e posaçërisht insistimit të vëllaut të madhë L.M. , se kush ja ka përdorur telefonin, i njëjti vetëm është përgjigjur nuk e di se kush ma ka përdorur telefonin. I akuzuari ka pranuar që telefoni nga i cili është dërguar SMS-i është i tij. I akuzuari na ka njoftuar që ka qenë në punë në kohën kur është dërguar SMS.Sa e di unë më herët nuk ka pasur të tilla raste i akuzuari që ti përdorej telefoni pa e ditur vet ai. Me përmbajtjen e SMS që e kemi kuptuar nga vëllau, familja ime kemi qenë nën ndikim të frikës dhe ankthit.

Me këtë SMS ka pësuar familja ime shqetësimi dhe frika si dhe ankthi kanë qenë ato që kanë lë si pasojë për mua personalisht, dhe për familjen time dërgimi i SMS me atë përmbajtje.

Dëshmitari H.B. , në shqyrtimin gjyqësor me datë 20.06.2016, deklaron: po unë e kam përpiluar kallëzimin penal në këtë çështje penale, jo nuk kemi hapur rast tjetër penal lidhur me

pronarin e numrit nga i cili është dërguar SMS nga telefoni i të akuzuarit. Arsyeja ka qenë që numri që e kemi kërkuar nga zyrtarët kompetent të PTK-ës - Vala 900, na ka dalë që numri i telefonit është me një pronar në Ferizaj, por numri i IMEI të telefonit ka qenë i këtui tani të akuzuarit J.B. . Me rastin e të dhënave tona, kemi konstatuar që numri gjegjësisht Sim kartela e përdorur në telefonin e J.B. , sipas IMEI, ka qenë me numër të SIM kartelës të pronarit në Ferizaj, por kartela paraprake e shfrytëzuar në telefonin e J.B. , për herë sipas IMEI, ka qenë SIM kartela e J.B. , po ashtu pas përdorimit të SIM kartelës nga e cila është dërguar SMS përsëri në telefonin e J.B. është vendosur është edhe SIM kartela e J.B. . Për të gjitha të cekurat më lart, ka rezultuar edhe përshkrimi i lokacionit se ku ka funksionuar numri i telefonit si dhe vetë telefoni sipas IMEI, e që ka rezultuar që frekuencat e të njëjtëve kanë qenë në fshatin , fjala është edhe për SIM kartelat, edhe për vet telefonin. Nuk është konfiskuar telefoni i të akuzuarit J.B. . Ne bëjmë kërkesë në Prokurori, dhe me anët të prokurorisë urdhërohet shërbimi i nevojshëm në këtë rast operatori Vala 900 që të na sigurojë të dhënat e nevojshme që i kërkojmë, dhe në bazë të gjeturave të tyre të njëjtit na parashtrajnë informacionet në bazë të përvojës së tyre. Përmbajtja e CD-es deklarohet që është vetëm numri i IMEI dhe numrat kontaktues që janë përdorur në telefon, si dhe lokacioni prej nga ku është përdorur respektivisht nga cili lokacion është dërguar SMS. Unë të dëmtuarin D.M. e kam uhdëzuar që të hapë rast të ri, si person fizik, për shkak të SMS të ri të pranuar, mua si profesionalist nuk më është lejuar dhe nuk e di që i kam thënë dhe jam plotësisht i sigurt që nuk i kam thënë që është personi i njëjtë, ngase as vet D.M. nuk e ka ditur se kush e ka dërguar SMS, deri sa i përket kësaj nuk e ka njoftuar Prokuroria. Sa kam unë njohuri nuk e di që ndaj të akuzuarit J.B. është hapur edhe ndonjë rast tjetër penal.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 13.07.2016, është bërë leximi i shkresave dhe ate kallëzimit penal nr. -GA-.... të datës 27.04.2015, raportit fillestar të incidentit, raporti i oficerit të datës 03.04.2015, procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarës E.M. , në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit D.M. , në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit A.F. , në procedurën parapenale, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B.M. , në procedurën parapenale dhe CD.

I akuzuari J.B. , në shqyrtimin gjyqësor me datë 13.07.2016, në mbrojtjen e vet deklaron: Në vitin 2015, konkretisht në muajin prill të këtij viti, kam poseduar numrin e operatorit vala dhe ate ... - ... - ... , e posedoj edhe sot këtë numër. Kam pasur edhe numër tjetër të kompanisë IPKO, të cilin numër e ka mbajtur familja për nevojat familjare. Nuk e di numri i kujt është numri i telefonit dhe ate ... - ... - Para rastit të ndodhur siç është përshkruar në aktakuzë kemi qenë në raporte shumë të mira shoqërore me familjen M. , konkretisht me D.M. dhe B.M. , duke pasur parasysh se kemi qenë bashkë fshatarë, andaj kemi pasur raporte të shëndosha sipas traditave tona popullore. Këto raporte pakës janë ftohur, dhe unë jam i zhgënjyer në D.M. dhe B.M. , pasi që të njëjtit kanë ra në provokime të këtij rasti. Sa i përket raporteve me A.F. , kanë qenë shumë të mira, por edhe me të njëjtin pas këtij rasti, raportet pak janë ftohur, por nuk janë plotësisht të

këqija. E kam ditur numrin e telefonit të dyve edhe të D.M. edhe të B.M. , në kohën kur pretendohet kryerja e veprës, kemi komunikuar kohë pas kohe kur kemi pasur nevojë, e po ashtu kjo vlen edhe për A.F. . Telefonin jam munduar dhe e kam mbajtur me vete zakonisht. Nuk më kujtohet saktë, por ekziston mundësia që kam komunikuar nëpërmjet SMS me të njëjtit për ndonjë urim.

Unë nuk i kam shkruar këto mesazhe. me përmbajtje kërcënuese, të drejtuara të dëmtuarve nëpërmjet telefonit të D.M. . Nuk mund ta di si ka ndodhur kjo. Edhe pse të njëjtat janë dërguar nga telefonit im sipas raporteve të operatorit. Pas rastit të ndodhur kanë ardhur te unë dhe ate të dëmtuarit D.M. dhe A.F., dëshmitari B.M. si dhe L.M. vëllau i të dëmtuarit D.M. . Jam betuar, sipas traditave, dokeve dhe zakoneve popullore se unë personalisht nuk i kam dërguar SMS e cekur, këtë e ka vërtetuar edhe i dëmtuari A.F. , në shqyrtimin gjyqësor. Unë mund të betohem, edhe sot para gjykatës betohem që unë nuk i kam dërguar ato SMS dhe kudo që është nevoja dhe vendi mund të betohem. Nuk e njoh askend nga Ferizaji, as ndonjë shokë, mikë apo dikën të njohur. Profesionimi është si theksova në fillim murator, punëtor ndërtimtarie.

Mendoj dhe jam shumë i bindur se dikush e ka përdorur telefonin tim, të them më konkretisht më ka keq përdorur. Sa e di unë telefoni mobil më ka humbur diku para 2-3 viteve në fshatin , dhe të njëjtin më nuk e kam gjetur asnjëherë, ka qenë i markës “Samsung”, mirëpo telefoni me këtë numër të IMEI sipas të thënave të postës të operatorit, nuk ka qenë, pasi që i njëjti nuk më ka humbur asnjëherë. Nuk e di dhe nuk mund të deklarojem konkretisht lidhur me ndonjë person të caktuar, kush ka mundur të keq përdor telefonin tim.

Nuk e di ku kam qenë konkretisht atë ditë, me datën 03.04.2015. rreth orës 08,19 minuta, unë ato ditë kam punuar si punëtor ndërtimtarie që e kam profesion, e di vetëm që në deklaratën time në Stacionin policor, hetuesit policor më kanë njoftuar nëpërmjet hartografisë të gjitha hyrjet dhe daljet në fshat, dhe se atë ditë pra me datë 03.04.2015, ka pas reshje të shiut, dhe në këto kushte klimatike unë nuk mund të punoj.

Po është e vërteta, që në ditën kritike kam qenë në Mamushë, së bashku me punëtorët e mi duke punuar punë ndërtimtarie, ndërsa sipas të gjeturave të hartografisë, kanë qenë një ditë përpara. Në ditën kur kam dhënë deklaratën në Stacionin policor, kam qenë në emocione, duke pasur parasysh faktin që jam akuzuar për një veprim që unë jam i bindur që personalisht nuk e kam bërë, dhe nuk kam pasur dëshirë të kem problem me familjen M. dhe F. , pasi që me të njëjtin deri në atë ditë i kam pasur raportet si theksova më lart shumë të mira.

Nuk e di dhe nuk jam plotësisht i sigurt se ku e kam pasur telefonin në ditën dhe orën si në dispozitiv të aktakuzës, pasi që më herët nuk jam ballafaquar me të tilla raste si në këtë rast, me siguri dhe jam shumë i bindur që nuk ka ndodhur një ditë para ditës kritike, apo më konkretisht para ditës kritike në çfarëdo kohe qoftë që nga telefoni im ti dërgohet dikujt ndonjë

SMS me përmbajtje kërcënuese. Numrin e telefonit të D.M. në telefonin tim e kam të regjistruar me emër dhe mbiemër të plotë D.M. .

E di që për të gjitha sendet që gjenden në posedim dhe në pronësinë time dhe të secilit person, për të gjitha pasojat eventuale të shkaktuara nga ai send, përgjegjësia i takon pronarit të sendit apo poseduesit. Po nga të cekurat ashtu rrjedhë, ndonjë lloj përgjegjësie për pasojën e shkaktuar në rastin konkret, por unë as sot nuk e di se si ka ndodhur e tërë kjo, më vije keq që ka ardhur deri te kjo, shprehi keq ardhje me zemër të plotë familjes M. dhe F. .

Në fund mund të theksoj që është edhe e rëndësishme për këtë çështje që unë me familjen M. , konkretisht me vëllezërit e të dëmtuarit D.M. dhe dëshmitarit B.M. , F. M. kemi qenë shok shumë të ngushtë, unë me profesionin tim të muratorit e kam ndërtuar shtëpinë e familjes M. si dhe shumë ndihma të tjera që e kemi bërë njeri tjetrit, qoftë unë personalisht me F.M. , qoftë familja familjes, të gjitha këto sipas rregullave, traditave dhe dokeve tona popullore. Mund të them dhe mund të betohem në fëmijët e mi, që unë e kam vetëm një vëlla, por vëllaun e të dëmtuarit dhe dëshmitarit F.M. , e kam konsideruar si vëlla timin, edhe pse i njëjti pas këtij rasti, më është larguar pak. Besoj që edhe F.M. , po ashtu më ka konsideruar mua si vëlla. Të gjitha këto theksoj dhe shprehi keq ardhjen andaj edhe nga kjo më vije keq për tërë këtë që ka ndodhur.

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata në mënyrë të plotë dhe të saktë vërtetoi në tërësi gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv dhe atë në bazë të deklaratave të dëmturve E.M. , D.M. dhe A.F. dhe të dëshmitarve B.M. dhe H.B. si dhe deklaratës të vet të akuzuarit J.B. se nuk është kontestuese aspak fakti që D.M. , me datë 03.04.2016 ka pranuar një SMS me përmbajtje kërcënuese “me jetë”, bashk me kunatën e tij – të dëmtuarën E. M. dhe fqin e tij – të dëmtuarin A.F., e poashtu në të njëjtën ditë SMS me përmbajtje kërcënuese pranon edhe i dëmtuari A.F. . Nga deklarata e dëshmitarit zyrtarit policor H.B. , në tërësi vërtetohet në bazë të raportit të operatorit Vala, se telefoni nga i cili është dërguar SMS me përmbajtje kërcënuese e që janë objekt i akuzës, janë dërguar nga telefoni i të akuzuarit J.B. , por me rastin e dërgimit është bërë ndërrimi i SIM kartelave, kjo vërtetohet nga numri i IMEI të telefonit të akuzuarit. Këtë e vërteton edhe deklarata e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor deklaroi dhe mbrohet me deklaratë se dikush ja ka keqpërdorur telefonin dhe se nuk e din se kush ja ka keqpërdorur telefonin për dërgimin e SMS kërcënuese. Një deklaratë e tillë e të akuzuarit sipas mendimit të gjykatës ka për qëllim të vetëm shmangëjen nga përgjegjësia penale dhe vënien në lajthim të gjykatës lidhur me veprën penale, e në drejtim të kësaj është edhe fakti që kur të dëmtuarit D.M. dhe A.F. , së bashku me dëshmitarin B.M. dhe vëllaun e të dëmtuarit dhe dëshmitarit L.M., kanë shkuar te J.B. , për të kërkuar sqarim lidhur me këtë pasi kanë kuptuar se SMS janë dërguar nga ai, i njëjti ka qenë i shqetësuar, i skuqur dhe me të vetmen përgjigje dikush ma ka keqpërdorur telefonin, por i njëjti e din që për të gjitha sendet që gjenden në pronësi dhe posedim të personit, përgjegjësia për dëmet eventuale të shkaktuara nga ai send i takon pronarit apo poseduesit, pra edhe përkundër deklaratës të akuzuarit që ai nuk e ka dërguar SMS dhe se telefoni i është

keqëpërdorur, pa e ditur nga kush dhe si, gjykata konsideron se një deklaratë e tillë është qëllim që të vë në lajthim gjykatën lidhur me fajësin e të akuzuarit, ngase është e pamundur që një person mos të vërej ndërrimin e SIM kartelës, aq më pak këtu i akuzuari i cili thekson që vazhdimisht e ka poseduar dhe e ka pasur pranë vetes telefonin e vet, e poashtu edhe nga fakti që ndërrimi i SIM kartelës është bërë me të vetmin qëllim të mshefjes të gjurmëve të veprës penale. Nga raporti i operatorit Vala është konstatuar që SMS janë dërguar nga fshati , që më shumë e forcon bindjen që ndërrimi i SIM kartelës është bërë me qëllimin e cekur më lartë. Andaj një mbrojtje të tillë gjykata nuk ja fali fare besimin, ngase është në kundërshtim me vetëveten, është mjaft e paqartë, e zbehtë dhe kontradiktore. Deklaratat e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve si dhe vetë të akuzuarit si dhe në bazë të provave materiale të administruara në tërësin e tyre janë identike për nga përmbajtja. Me këto veprime i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm se me veprime të tilla shkakton një pasojë të ndaluar, duke i shkaktuar frikë dhe ankth të dëmtuarve, andaj i njëjti me dashje ka ndërmarr veprimet e cekura për të kryer veprën penale të kanosjes. Andaj, gjykata pas administrimit të provave të cekura më lartë, analizimit dhe shqyrtimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjitha së bashku, si dhe pas vlerësimit të të njëjtave, nga të cekurat ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore që si tërësi formojnë figurën e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-së, të përshkruar si në shqiptim të aktgjykimit dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykoj sipas ligjit, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tij, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, është person familjar, është baba i katër fëmijëve, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, shprehja e keqardhjes të akuzuarit për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen korekte të tij gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj, duke menduar se dënimi i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP.

Vendimin mbi kërkesën pronësore juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1135/2015 me datë 22.07.2016

Procesmbjatesja
Naxhis Sharani,

Gjyqtari,
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,gjykatës së apelit në Prishtinë,nëpërmjet kësaj gjykate.